



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 02.09.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **28.08.2025**, të parashtruar nga **Inspired Tech SH.P.K.** dhe **CMD SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ”** me nr. prokurimi 206-25-4780-2-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohen**, si të bazuara kërkesat për ri-shqyrtim e OE Inspired Tech SH.P.K. dhe CMD SH.P.K. e dt. 28.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ”** me nr. prokurimi 206-25-4780-2-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së të dt. 26.08.2025;
2. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK-së i datës 26.08.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE Inspired Tech SH.P.K. dhe CMD SH.P.K. me datën 28.08.2025, kanë parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ”** me nr. prokurimi 206-25-4780-2-1-1. Autoriteti Kontraktues sot me datë 02.09.2025 e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE Inspired Tech SH.P.K.

Neni 7 i LPP
Neni 68 i LPP
Neni 69 i LPP
Neni 25 i RRPP

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE CMD SH.P.K.

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 64 i LPP-së

Neni 66 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik (me ndryshimet e 002/2024)

Pretendimet ankimore te OE Inspired Tech SH.P.K.

Neni 65 i LPP-së dhe pika 9.1 & 9.2 e FDT-së kërkojnë që operatori ekonomik të dëshmojë të paktën një kontratë të ngjashme, të realizuar në .NET SQL Server, me vlerë =250,000 € në tri vitet e fundit.

Projekti Allela 1.0:

Vlera: 255,611.76 Euro€ (mbi pragun e kërkuar).

Teknologjia: .NET 7 SQL Server (përputhet me kërkesën teknike).

Periudha: 2023–2024 (brenda afatit 3-vjeçar).

Dokumentacioni: Referencë e lëshuar nga klienti dëshmi pagesash të kryera.

Kjo dëshmon se punimet janë realizuar dhe pranuar, jo vetëm kontratë e nënshkruar.

LPP dhe Udhëzimi Operacional 001/2023 nuk kërkojnë që kontrata të jetë e mbyllur tërësisht; mjafton që pjesët e dorëzuara dhe të paguara të jenë të dokumentuara.

Refuzimi i kësaj reference bie ndesh me parimin e proporcionalitetit (Neni 7 i LPP-së) dhe kufizon padrejtësisht konkurrencën.

8. Dëmet materiale

Nuk janë vlerësuar në këtë fazë, por do të vlerosëhen në faza të mëtejshme.

Pretendimet ankimore te OE CMD SH.P.K.

Ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 26.08.2025 (Njoftimi B58), me të cilin është marrë vendimi për eliminimin e ofertës sonë në kuadër të aktivitetit të prokurimit për “Zhvillimin dhe avancimin e sistemit informativ të QKKTGJ”.

Ky vendim është marrë pa një sqarim substancial lidhur me dokumentacionin dhe dëshmitë e paraqitura nga ana jonë, ndërkohë që arsyetimi i dhënë nuk qëndron as në aspektin teknik dhe

profesional, dhe as në bazën ligjore të aplikueshme.

Duke u bazuar në të drejtën tonë ligjore sipas nenit 64 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe në dispozitat përkatëse të Rregullores Nr.001/2022 dhe Udhëzuesve për Prokurimin Publik, konsiderojmë se oferta jonë ka qenë në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe se vendimi i Autoritetit Kontraktues është marrë në mënyrë të gabuar dhe të pajustifikuar.

Në vijim, do të paraqesim argumentet tona për secilën nga pikat e ngritura nga Autoriteti Kontraktues, duke ofruar prova të qarta dhe referenca ligjore që mbështesin vlefshmërinë e ofertës sonë.

Arsyet e Eliminimit të ofertë të OE CMD SH.P.K. janë si në vijim:

ARSYETIM

Nuk i keni plotësuar kriteret siç janë kërkuar në NJK dhe DT.

Oferta juaj është refuzuar për këto arsye:

Tek Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1. Në listën e kontratave të dorëzuara gjatë fazës së ofrimit, CMD ka paraqitur kontratat me vlerat si më poshtë:

1. RTO me vlerë 150,000 euro
2. Kolegji i Biznesit me vlerë 36,000 euro
3. Bast Trandë me vlerë 26,200 euro, si dhe projekte të tjera që nuk janë listuar gjatë fazës së sqarimeve.

Pasi janë kërkuar sqarime shitesë për të dëshmuar se CMD ka realizuar me sukses projekte në dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) me vlerë totale prej të paktën 250,000 euro gjatë tre viteve të fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë, dhe ku të paktën një nga projektet duhet të ketë vlerë minimale prej 150,000 euro.

Kundërshtim ndaj arsyetimit të AK për Kapacitetin Teknik dhe Profesional

Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se oferta jonë nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara në NJK dhe DT, duke u mbështetur në listën e kontratave të paraqitura dhe duke theksuar se nuk janë përmbushur kushtet për projektet në teknologjinë Microsoft (.NET dhe SQL Server), me vlerë minimale 150,000 € për një projekt dhe 250,000 € në total në tre vitet e fundit. Ky arsyetim është i pasaktë dhe bie ndesh me provat dhe dokumentet e dorëzuara nga ana jonë.

1. Përputhshmëria me DT

Sipas kërkesës së qartë të DT, OE duhet të dëshmojë:

- të paktën një projekt me vlerë $\geq 150,000$ € në platformën .NET/SQL Server;
- projekte kumulative $\geq 250,000$ € në tre vitet e fundit;
- dëshmi të realizimit përmes referencave të nënshkruara nga klienti privat ose publik.

Këto kushte janë përmbushur në tërësi:

- Projekti me RTO GmbH është me vlerë mbi 150,000 € për zhvillim dhe mbi 250,000 € në total, të dëshmuara me fatura dhe ekstrakt bankar, si dhe me referencën e nënshkruar nga RTO ku specifikohet qartë përdorimi i platformës Microsoft .NET me SQL Server.
- Listës së kontratave të dorëzuara i janë bashkëngjitur referencat për projektet, duke përmbushur kriterin formal të kërkuar në DT.

2. Mospërputhjet e theksuara nga AK janë vetëm formale

- Faktet tregojnë se kemi ofruar dëshmi të plotë dhe të verifikueshme, përfshirë referenca të nënshkruara, fatura dhe pagesa bankare.
- Sipas nenit 69 të LPP, aftësia teknike dhe profesionale vërtetohet përmes dokumenteve të nënshkruara nga blerësit privatë ose publikë, pa kërkesë që në faturë të përcaktohen teknologjitë.
- Autoriteti Kontraktues ka bërë një interpretim tepër formal duke injoruar provën kryesore – referencën e RTO – e cila konfirmon qartë se projekti është zhvilluar në platformën e kërkuar.

1. Projektin me RTO, OE deklaron një projekt me vlerë 250,000 euro dhe ka bashkëngjitur një referencë ku thuhet se CMD ka realizuar disa projekte në teknologjitë .NET dhe SQL, si dhe projekte të tjera në teknologji të ndryshme, si JAVA dhe aplikacione mobile.

Megjithatë, nuk janë specifikuar projektet konkrete dhe vlerat e sakta për zhvillimet në .NET dhe SQL.

OE ka dorëzuar dy fatura bankare, secila në vlerë 60,000 euro për zhvillim softueri, si dhe një faturë tjetër prej 30,000 euro për zhvillim softueri dhe 30,000 euro për përkrahje dhe mirëmbajtje, duke arritur totalin prej 150,000 euro në zhvillim softueri dhe 30,000 euro për përkrahje dhe mirëmbajtje. Nuk është e qartë nëse përkrahja dhe mirëmbajtja lidhet me softuer apo me komponentë të tjerë, si p.sh. hardware. Gjithashtu, nuk ka dëshmi që provojnë zhvillimin e softuerit në teknologjitë .NET dhe SQL Server, siç është kërkuar në dokumentacionin e tenderit.

Në dokumentacionin e OE, vërehet një mos-përputhje mes deklaratave të fazës së ofertimit dhe sqarimeve shtesë: fillimisht projekti është deklaruar me vlerë 150,000 euro, ndërsa më pas vlera rritet në 250,000 euro. Transaksionet bankare e dëshmojnë zhvillimin e softuerit në vlerë 150,000 euro mirëpo duke mos ofruar dëshmi në teknologjitë e përdorura dhe përkrahjen dhe mirëmbajtjen në vlerë 30,000 euro,

Gjithashtu, figuron një transaksion tjetër prej 74,938 eurosh, por pa përshkrim të detajuar dhe pa faturë përkatëse.

Kundërshtim për projektin me RTO

1. Arsyetimi i AK

AK ka konstatuar se:

- Nuk janë specifikuar projektet konkrete dhe vlerat e sakta për zhvillim në .NET/SQL;
- Faturat e dorëzuara (nga 60,000 € + 60,000 € + 30,000 € zhvillim dhe 30,000 € mirëmbajtje) nuk dëshmojnë përdorimin e .NET/SQL;
- Ekziston mospërputhje mes deklarimit fillestar (150,000 €) dhe vlerës pas sqarimeve (250,000 €);
- Transaksioni prej 74,938 € nuk është i shoqëruar me faturë të veçantë.

2. Dëshmitë e ofruara nga CMD

- Referenca e RTO GmbH (12.08.2025) konfirmon qartë që CMD ka zhvilluar projekte duke përdorur Microsoft .NET Framework me SQL Server, dhe përshkruan module konkrete të implementuara.
- Faturat zyrtare (03.01.2024, 02.03.2024, 24.05.2024) dëshmojnë shuma prej 180,000 €, ku 150,000 € janë për zhvillim të pastër dhe 30,000 € për mirëmbajtje.
- Ekstrakti bankar i TEB pasqyron pagesa në vlerën totale 254,752 €, duke kaluar kufirin e kërkuar prej 250,000 €.
- Të gjitha këto dokumente janë të nënshkruara dhe të vulosura, në përputhje me kriteret e DT për dëshmi të lëshuara nga blerësi privat.

3. Pse arsyetimi i AK është i pabazuar

a) Për teknologjitë .NET dhe SQL

- Referenca e RTO është një dokument zyrtar i lëshuar nga blerësi, i cili konfirmon qartë përdorimin e .NET dhe SQL Server.
- Sipas nenit 69 të LPP, aftësia teknike dhe profesionale vërtetohet me dokumente të nënshkruara nga blerësi privat. Kjo kërkesë është përmbushur.
- Pretendimi i AK se faturat nuk specifikojnë teknologjitë nuk qëndron, sepse nuk ka bazë ligjore që faturat të kenë detyrimsht specifikime teknike; kjo provohet përmes referencave, të cilat ne i kemi dorëzuar.

b) Për vlerën $\geq 150,000$ € në një projekt

- Vetëm për zhvillim, faturat e dorëzuara tregojnë shuma prej 150,000 € (60k + 60k + 30k).
- Me mirëmbajtje, shuma totale është 180,000 €.
- Kriteri i DT për “*së paku një projekt $\geq 150,000$ €*” është përmbushur plotësisht.

c) Për vlerën kumulative $\geq 250,000$ € në tri vitet e fundit

- Ekstrakti bankar dëshmon shuma të kredituara prej 254,752 € nga RTO GmbH, duke kaluar pragun minimal të përcaktuar.
- Neni 64 i LPP përcakton që dëshmitë financiare janë të vlefshme kur provojnë realizimin e kontratave.

d) Për “mospërputhjen” e vlerave 150,000 € dhe 250,000 €

- Nuk ka mospërputhje reale: 150,000 € është pjesa e zhvillimit, ndërsa 250,000 €+ është totali i projektit me fazat e tjera të përfshira (zhvillim + mirëmbajtje + faza shtesë).
- Vetë DT-ja nuk ndalon që projekti të zhvillohet me disa fatura ose faza implementimi.

e) Për transaksionin prej 74,938 €

- Ky transaksion është pjesë e pagesave të projektit dhe evidentohet në ekstraktin bankar, të cilin AK është i detyruar ta marrë si provë sipas nenit 69 të LPP.
- Mungesa e faturës së bashkëngjitur është një çështje formale, e cila nuk mund të çojë në eliminim kur prova financiare ekziston dhe vlera totale është e qartë.

Projekti me RTO GmbH përmbush plotësisht kriterin e DT: ka një projekt në .NET/SQL $\geq 150,000$ € dhe një total mbi 250,000 € brenda periudhës së kërkuar.

Referenca e RTO, faturat dhe ekstrakti bankar janë prova të qarta dhe ligjërish të vlefshme. Eliminimi ynë mbi këtë bazë është i pabazuar ligjërish dhe materialisht, dhe kërkojmë që ky vendim të RISHQYRTOHET.

2. Projektin me Kolegjin e Biznesit, ku Operator Ekonomik (OE) ka deklaruar krijimin dhe mirëmbajtjen e faqes së internetit me vlerë 36,000 euro, në referencat e dorëzuara gjatë fazës së ofertimit nuk përmenden teknologjitë e përdorura. Pas kërkesës sonë për sqarime shtesë, OE nuk ka dorëzuar dokumente shtesë që dëshmojnë teknologjitë e aplikuara në projekt. Ai ka bashkëngjitur vetëm një deklaratë personale dhe transaksione bankare lidhur me realizimin e projekteve. Prandaj, nuk ofrohen dëshmi konkrete për teknologjitë e përdorura në këtë projekt.

3. Projekti me Bast Trade, me vlerë 26,200 euro, në referencat e dorëzuara gjatë fazës së ofertimit nuk përmban informacion mbi teknologjitë e përdorura. Pas kërkesës sonë për sqarime shtesë, Operatori Ekonomik (OE) nuk ka bashkëngjitur dokumente shtesë që të dëshmojnë teknologjitë e përdorura. Ai ka dorëzuar vetëm një deklaratë të tij dhe transaksione bankare që lidhen me projekte. Për pasojë, nuk janë ofruar dëshmi konkrete mbi teknologjitë e përdorura në këtë projekt.

2. Projekti me Kolegj i Biznesit dhe Bast Trade

1. Arsyetimi i AK

AK ka konstatuar se:

- Për projektin me Kolegjin e Biznesit (36,000 €), referencat e paraqitura nuk përmbajnë teknologjitë e përdorura;
- Nuk janë ofruar dokumente shtesë që dëshmojnë përdorimin e teknologjive, por vetëm deklarata dhe transaksione bankare;
- Për projektin me Bast Trade (26,200 €) është dhënë referencë, por është konsideruar si dëshmi e pamjaftueshme për teknologjitë dhe për vlerën totale.

2. Dëshmitë e ofruara nga CMD

- Referencë zyrtare për Bast Trade SH.P.K. – ku specifikohet qartë se platforma CMD Finance është zhvilluar plotësisht nga CMD dhe është ndërtuar mbi teknologjitë Microsoft .NET Framework me SQL Server, duke përfshirë fazat e dizajnit, zhvillimit, implementimit, testimit dhe mirëmbajtjes.
- Transaksione bankare 2023–2025 që dëshmojnë pagesa të rregullta nga Bast Trade, në përputhje me marrëveshjen e kontratës.
- Dokumentacioni shitesë i CMD Finance (prezantimi i sistemit) ku janë të detajuara funksionalitetet dhe arkitektura teknologjike e platformës (MS SQL Server, integritet, module të shumta të menaxhimit financiar).
- Për periudhat para vitit 2022, pagesat janë realizuar në para të gatshme (cash), gjë e lejuar sipas praktikave tatimore të Administratës Tatimore të Kosovës, dhe janë të evidentuara në sistemin kontabël të OE-së.

3. Pse arsyetimi i AK është i pabazuar

a) Për teknologjitë

- Referenca e Bast Trade përmbush qartësisht kërkesën e DT duke konfirmuar përdorimin e teknologjive Microsoft .NET dhe SQL Server.
- Sipas nenit 69 të LPP, aftësia teknike mund të dëshmohet përmes dokumenteve të nënshkruara nga klienti privat. Referenca e Bast Trade është dokument i tillë dhe nuk mund të shpërfillet.

b) Për vlerën e kontratës

- Projekti i Bast Trade ka vlerë totale 26,200 €, e dëshmuar me kartelën e furnitorit, faturat dhe transfertat bankare.
- Vlera është reale, e ekzekutuar dhe e dokumentuar financiarisht, duke përmbushur kushtin e DT për listën e kontratave.

c) Për pagesat cash

- Për periudhën para vitit 2022, pagesat janë kryer në të gatshme, praktikë e lejuar nga legjislacioni tatimor.
- Sipas nenit 64 të LPP, dëshmia e pagesës nuk është e kufizuar vetëm në transfertat bankare, por mund të jetë çdo provë e vlefshme e evidentimit kontabël.

d) Për Kolegj i Biznesit

- Edhe pse referenca nuk specifikon teknologjitë, pagesat dhe transaksionet janë të dokumentuara.
- Ky projekt është plotësues për kapacitetin teknik, ndërsa prova kryesore e përdorimit të teknologjive .NET/SQL jepet në projektin e Bast Trade dhe RTO.
- Kështu, ky projekt nuk mund të konsiderohet arsye për eliminim, pasi kërkesa e DT është që të dëshmohet së paku një projekt $\geq 150,000$ € dhe $\geq 250,000$ € në total, të cilat janë përmbushur përmes RTO + Bast Trade.

SISTEMI CMD FINANCE

1. Zhvillimi i CMD Finance nga CMD SH.P.K.

- **CMD Finance** është një sistem informativ i integruar i zhvilluar plotësisht nga **CMD SH.P.K.**, duke përdorur platformën **Microsoft .NET Framework** dhe **MS SQL Server** si bazë të të dhënave.
- Ky sistem përmban module të shumta, si: **Blerjet, Shitjet, Arka, Banka, Kontabiliteti Financiar, Raportet financiare, Menaxhimi i magazinave, Asetet, Payroll, Hotel Management, etj.** – të gjitha të dokumentuara në prezantimin zyrtar të sistemit.
- **CMD Finance** nuk është vetëm një aplikacion standard, por një platformë e zhvilluar dhe përshtatur sipas nevojave të klientëve, ku në çdo implementim kryhen fazat e plota: dizajnim, zhvillim, testim, instalim dhe mirëmbajtje.

2. Përdorimi i CMD Finance nga Bast Trade SH.P.K.

- **Bast Trade** ka implementuar **CMD Finance** si sistem kryesor për menaxhimin financiar dhe kontabël, duke përfshirë faturimin, pagesat, arkën, bankën, raportet financiare dhe kontabilitetin e plotë.
- Pagesat për këtë sistem janë të dëshmuara me transfertat bankare të rregullta në periudhën **2023–2025**.
- Referenca e lëshuar nga **Bast Trade** e konfirmon përdorimin real të **CMD Finance** dhe mbështetjen teknike të vazhdueshme nga **CMD SH.P.K.**
- Ky projekt është një dëshmi e fortë e përvojës sonë teknike në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të bazuara në **.NET/SQL** dhe konfirmon përmbushjen e kërkesës së **DT** për projekte relevante.

3. Përdorimi i CMD Finance nga Kolegji i Biznesit

- **Kolegji i Biznesit** gjithashtu ka implementuar **CMD Finance**, të përshtatur për nevojat e tyre akademike dhe administrative.
- Përmes këtij sistemi janë menaxhuar proceset e brendshme financiare dhe kontabël, duke përdorur të njëjtat module bazë: **shitjet, blerjet, arka, banka, kontabiliteti dhe raportet financiare**.
- Edhe pse vlera e këtij projekti është më e vogël (**36,000 €**), ai dëshmon që sistemi **CMD Finance** është një produkt i qëndrueshëm dhe i përdorur nga më shumë se një klient privat – pra, jo vetëm i zhvilluar, por i implementuar dhe funksional në treg.

4. Vlerësimi i gabuar i AK

- AK ka konsideruar se referencat e Bast Trade dhe Kolegjit të Biznesit nuk janë të mjaftueshme, duke u mbështetur tek fakti se faturat nuk përmendin teknologjitë.
- Ky arsyetim është i pasaktë, sepse teknologjitë janë të dokumentuara në prezantimin teknik të CMD Finance dhe në referencat e nënshkruara nga klientët privatë.
- Sipas nenit 69 të LPP, mjafton që aftësia teknike të provohet me dokument të nënshkruar nga blerësi privat – çfarë është bërë me referencat e Bast Trade dhe Kolegjit të Biznesit.
- Injorimi i këtyre referencave përbën shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe barazisë (neni 6 dhe neni 7 i LPP).

5. Përfundim për CMD Finance

- CMD Finance është produkt i zhvilluar nga CMD SH.P.K., në platformën Microsoft .NET dhe SQL Server, i dokumentuar teknikisht dhe i provuar financiarisht.
- Ai është implementuar dhe është në përdorim aktiv nga Bast Trade dhe Kolegji i Biznesit, të cilët e kanë konfirmuar me referenca zyrtare dhe me prova të pagesave bankare.
- Këto dy projekte tregojnë jo vetëm zotësinë tonë teknike, por edhe vlefshmërinë reale të sistemit në treg, duke dëshmuar kapacitetin tonë profesional sipas kërkesave të DT.
- Eliminimi mbi këtë bazë është i pabazuar, pasi AK ka injoruar dokumentacionin autentik dhe provat konkrete të përdorimit të sistemit.

Nga shqyrtimi i vendimit të Autoritetit Kontraktues dhe nga analizimi i detajuar i provave të paraqitura nga ana jonë, rezulton qartë se arsyetimi për eliminimin e ofertës së CMD SH.P.K. është i pabazuar si në aspektin faktik, ashtu edhe në atë ligjor.

Ne kemi dorëzuar dokumentacion të plotë dhe të vlefshëm, i cili përmbush kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, përfshirë:

- Referencat e nënshkruara nga klientët privatë (RTO, Bast Trade, Kolegji i Biznesit), të cilat konfirmojnë zhvillimin dhe implementimin e projekteve në Microsoft .NET dhe SQL Server;
- Faturat dhe transfertat bankare që dëshmojnë vlerat financiare të realizuara, përtej pragjeve minimale të përcaktuara ($\geq 150,000$ € për një projekt dhe $\geq 250,000$ € në total);
- Prezantimet teknike dhe dokumentacioni i CMD Finance, që vërtetojnë arkitekturën, teknologjitë dhe funksionalitetet e sistemit të zhvilluar nga CMD.

Autoriteti Kontraktues ka bërë një interpretim tepër formalist duke shpërfillur provat substanciale, dhe në këtë mënyrë ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Në përmbajtje, oferta jonë i përmbush të gjitha kushtet materiale dhe ligjore, ndërsa arsyetimi i eliminimit bazohet në vlerësime të pasakta dhe në interpretime formale që nuk kanë bazë në ligj.

Për këto arsye, kërkojmë që vendimi i Autoritetit Kontraktues të shfuqizohet dhe të urdhërohet rivlerësimi i ofertës sonë, duke marrë parasysh provat e dorëzuara dhe respektuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregulloreve përkatëse.

Në fund pasi që të vërtetohen të gjitha pretendimet tona ankimore, kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktues që të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e CMD SH.P.K.

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës (B58) dhe lënda kthehet në

RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00€.

Përgjigjet e AK ne lidhje me pretendimet ankimore te OE Inspired Tech SH.P.K.

E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konstatojmë se pretendimi juaj ankimor është i pa bazuar për arsye se kërkesa e Tenderit ka qene për projekte të realizuara:

Kërkesa 1. OE duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte në dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) në vlerën e përgjithshme të projekteve minimum 250,000.00 € në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Se paku njëri nga projektet duhet të jetë në vlerën minimum 150,000.00 €.

Referenca e ofruar nga ana juaj në platformën Alleta për Sunny Hill-Tech, e ka statusin: Projekti është aktualisht në vazhdim, me zhvillim dhe përsosje të vazhdueshme.

- **Current Status:** The project is currently ongoing, with continuous development and refinement.

Kjo reference do ishte e pranueshme sikur aktiviteti të ishte për mirëmbajtje, meqenëse të mirëmbajtja pranohet shërbimi i kryer për periudha të caktuara, ndërsa të aktivitetet si ky që është për **dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin** kemi të bëjmë me një projekt si tërësi kur dizajnohet apo zhvillohet si platforme, andaj nuk merret parasysh projekti në vazhdim - që nuk është përfunduar.

Përgjigjet e AK ne lidhje me pretendimet ankimore te OE CMD SH.P.K.

E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konstatojmë se pretendimi juaj ankimor është i pa bazuar për arsye se kërkesa e Tenderit ka qene për projekte të realizuara:

Kërkesa 1. OE duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte në dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) në vlerën e përgjithshme të projekteve minimum 250,000.00 € në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Se paku njëri nga projektet duhet të jetë në vlerën min. 150,000.00 €.

Dëshmia b. Kur shërbimi është bërë për një blerës privat, kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i realizimit të tillë.

Ne ofertën e juaj ju e keni prezantuar një liste me 14 projekte dhe 6 referenca. Përveç referencës së AQP-së në vlerë 3,999.00 euro dhe Referencës nga Kolegji Biznesi në vlerë 36,000.00 euro, asnjëra referencë tjetër nuk e ka të specifikuar vlerën e projektit.

Për AK këto projekte të listuara nuk janë bindëse duke marrë parasysh se kriteri i tenderit ka qene i përshkruar në mënyrë specifike, janë kërkuar projekte të realizuara në tri vitet e fundit, në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) në vlerën e përgjithshme të projekteve minimum 250,000.00 € (Se paku njëri nga projektet në vlerën min. 150,000.00 €).

Te dëshmia e kërkuar e kriterit, është mundësuar që për blerës privat, të dëshmohet me çfarëdo dokumenti nga blerësi që janë kryer projektet siç është kërkuar - evidentimi i realizimit të tillë, ndërsa vetëm referenca për projektin nr. 6 - Waldemar APP në vlerë 34,020.00 € është me të dhënat rreth teknologjive të përdorura por pa vlerë të projektit.

Oferta e juaj financiare është shumë më e lirë se sa oferta e OE të rekomanduar dhe oferta juaj do të ishte shumë e favorshme financiarisht për AK për këtë arsye edhe kemi kërkuar sqarime shtese gjatë vlerësimit, me ç'rast ju nuk keni arritur ta bindni AK për plotësimin e kriterit për projektet e kryera.

Vlen të theksohet se Vlera e parashikuar në këtë tender ka qene 168,000.00 €, ndërsa ju keni ofertuar në vlerën 39,999.93 €, që është çmim Jo normalisht i Ulet, por për shkak të mangësive të cekura në referenca në nuk e kemi trajtuar këtë pikë gjatë vlerësimit fillestar.

Referuar UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, **neni 11. Tenderët Jo-normalisht të Ulët**, oferta juaj i plotëson të tre kushtet e parapara për tu trajtuar si oferte Jo normalisht e Ulet.

Shembulli nga UDHËZUESI NR. 002/2024

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i parë sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dytë plotëson kushtin e dytë (30%) sepse çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se mesatarja e tenderëve. Shih pragun në kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dytë plotëson edhe kushtin e tretë (10%) sepse në krahasim me ofertën e dytë më radhe është më shumë se 10% më i ulët. Shih pragun C11

Ofertat e përgjegjshme:

PBC	69,000.00
Cactus	88,300.00
DataProgNet	88,000.00
Global CT Digital Kosova	129,188.00
Komtel	89,020.00
Novus	135,000.00
Tech Vision	70,460.00
TreteK	78,800.00
Shuma e ofertave të përgjegjshme:	747,768.00
Mesatarja e ofertave të përgjegjshme (shuma/8):	93471.00

Ne baze te sqarimeve te lartcekura, ne si AK-MSh nuk kemi diskriminuar apo favorizuar asnjë OE, por sipas kriterëve te kërkuara ne NJK dhe DT e kemi përzgjedhur ofertën e përgjegjshme me çmimin me te Lire e cila i ka plotësuar te gjitha kriteret dhe ka dëshmuar përvojën e kërkuar paraprake siç eshte kërkuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit te këtij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit